

Punëtorja e trajnimit e UNESCO,, Ndërtimi i së ardhmes rezistente ndaj ndryshimeve klimatike:zhvillimi i kapaciteteve për adaptimin e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimi me reziqet nga katastrofat në lokalitete të zgjedhura nga UNESCO në Evropën Juglindore“ 17-21.10. vitit 2022., Ohër

Nga 17 deri më 21 tetor të vitit 2022 në Ohër, Byroja Rajonale për shkencë dhe kulturë e UNESCO-s në Evropë me seli në Veneci,Itali, me mbështetje logjistike të komisionit Kombëtar për UNESCO të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucione tjera përgjegjëse oraganizuan punëtori trajnimi „ Ndërtimi i së ardhmes rezistente ndaj ndryshimeve klimatike: zhvillim i kapaciteteve për adaptimin e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimi me reziqet nga katastrofat në lokalitete të zgjedhura nga UNESCO në Evropën Juglindore“.

Qëllimi i punorisë është që të përcaktohen ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe katastrofave natyrore mbi lokalitetet e trashëgimisë natyrore dhe botërore të UNESCO-s, siç janë rezervat e biosferës, gjeoparket globale dhe lokalitetet trashëgimisë botërore në Evropën Juglindore dhe të zhvillohen kapacitetet për gatishmëri dhe veprim në suaza të menaxhimit me trashëgiminë dhe lokaliteteve.

Në punëtori marrin pjesë rreth 30 ekspertë-përfaqësues nga 5 shtete nga Evropa Juglindore,Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Serbia dhe parashikuan ndërtimin institucionaë dhe profesional të kapaciteteve përmes organizimit të trajnimit në të cilën do të jenë të kyçura organet për menaxhimin me lokalitetet së bashku me organet për mbrojtjen civile, anët tjera të përfshira dhe ekspertë nga fusha e ndryshimeve klimatike, menaxhimin me reziqet nga katastrofat dhe mbrojtjen e rezervat e biosferës dhe lokaliteteve të trashëgimisë botërore.

Në hapjen zyrtare për të pranishmit fjalim pati zëvendësministri për Mjedisin jetësor dhe planifikimit hapësinor të Republikës së Maqedonisë së Veriut z-nja Hristina Oxhaklieska, sekretarit të përgjithshëm të Komisionit kombëtar për UNESCO, z-nja Ttajana Kraljevska-Llazarova, Kryebashkiaku të Ohrit, z. Kiril Pecakov dhe shefi i Departamentit për shkencë nga Bzroja Rajonale për shkencë dhe kulturë të UNESCO në Evropë, z. Xhonatan Bejker.